

zuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të publikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 77/16 gusht 2010), si dhe në kuptim me nenin 8, paragrafi 3, dhe nenin 42 Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/14 korrik 2011), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 12 qershor 2020, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR ZBATIMIN E SISTEMIT BONUS-MALUS

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton mënyrën e zbatimit dhe përlogaritjes së primtit duke përfshirë sistemin bonus-malus ashtu siç është e përcaktuar në nenin 8, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.
2. Kjo rregullore aplikohet nga të gjithë siguruesit dhe degët e siguruesve të jashtëm të licencuar në Republikën e Kosovës për shitjen e sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia.
3. Kjo rregullore nuk aplikohet për shitjen e sigurimit kufitar nga autopërgjegjësia.
4. Siguruesit obligohen të aplikojnë këtë rregullore vetëm për rastet e lëshimeve të policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për personat fizikë.
5. Zbatimi i sistemit bonus malus për personat juridikë rregullohet nga vetë siguruesit ose Byroja Kosovare e Sigurimit.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë siç përcaktohen në Ligjin Nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe/ose siç janë përkufizuar në vijim për qëllime të kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Sistemi Bonus-Malus** - është sistemi i cili zbatohet si korrektues i lartësisë së primtit të sigurimit të autopërgjegjësisë, bazuar në historikun e dëmeve të të siguruarit (policëmbajtësit).